

RAPORT I PREZANTIMIT TË GJETJEVE

Vlerësimi i kapaciteteve dhe mundësive të studentëve për përdorimin e TIK
- Pandemia COVID19

Projekti: “Laboratori i debatit mbi integrimin evropian në auditorët universitare”

Përgatiti Blerjana Bino, Menaxher Projekti, SCiDEV

Tiranë, 01.04.2020

Përmbajtja

Hyrje	3
Metoda dhe kampioni	4
Prezantimi i gjetjeve.....	6
Përfundime	9

List of Figures

Figure 1: Niveli i studimit i respondentëve	4
Figure 2: Gjinia e respondentëve.....	5
Figure 3: Statusi aktual gjatë pandemisë.....	6
Figure 4: Puna dhe mësimi gjatë pandemisë	6
Figure 5: Mësimi online	6
Figure 6: Infrastruktura në dispozicion.....	7
Figure 7: Lidhja me internet.....	7
Figure 8: Sa lehtë përdoren platformat online.....	8
Figure 9: Nevoja për debatet online	8

List of Tables

Table 1: Shpërndarja e respondentëve sipas institucionit arsimor	4
Table 2: Qyteti i banimit	5

Hyrje

Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) po respekton masat e distancimit social, me qëllim parandalimin e përhapjes së virusit në kuadër të pandemisë COVID-19. Në kuadër të masave të ndërmarra nga data 12 mars 2020 stafi i SCiDEV është duke punuar online për vijimësinë e aktiviteteve dhe projekteve. Për t'ju përshtatur sa më mirë situatës, komunikimi me partnerët dhe bashkëpunëtorët ka vazhduar përmes platformave alternative të komunikimit, duke mundësuar progresin e punës në përfitim të shoqërisë. Aktualisht SCiDEV është duke zbatuar projektin 'Debati për Integrimin European në Auditorët Universitar' me mbështetjen e Fondacionit për Shoqëri të Hapur në Shqipëri (OSFA). Sipas planit të punës në mars dhe prill 2020 do të organizoheshin debatet universitare në 11 institucione të arsimit të lartë. Ndërkohë që debatet në dy institucione ishin realizuar në dhjetor 2019 dhe shkurt 2020.

Në kushtet e pandemisë COVID-19, SCiDEV në dakordësi me grupin e pedagogëve dhe OSFA vendosën shtyrjen e debateve të planifikuara për një datë të dytë. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe SCiDEV ka lançuar nismën '#QëndronëShtëpi #QëndroAktiv', ku fton të gjithë ndjekësit të ndajnë me ne përmes fotove, mesazhe pozitive se si po e shfrytëzojnë periudhën e izolimit. Për më tepër, skuadra e projektit, pedagogët mentorë dhe studentët kanë qenë aktiv edhe përmes publikimit të shkrimeve në rubrikën e Blog-ut të debatit universitar mbi tema që lidhen jo vetëm me integrimin european, por edhe me aktualitetin: si ka ndryshuar realiteti ku punojmë e studiojmë nga pandemia.

Me qëllim që të përgatitemi për mundësinë e zhvillimit të debateve apo aktiviteteve të tjera online, SCiDEV në bashkëpunim me OSFA ndërmorri një pyetësor për të vlerësuar kapacitetet dhe mundësitë që kanë studentët pjesëmarrës për të arritur rezultatet e projektit përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në kushtet e reja të vetë-izolimit dhe distancimit shoqëror si pasojë e pandemisë COVID-19. Gjetjet e pyetësorit shërbejnë për të informuar vendimarrjen e SCiDEV lidhur me realizimin e debateve apo aktiviteteve të tjera online.

Ky raport paraqet gjetjet e pyetësorit dhe disa rekomandime për veprime të mëtejshme. SCiDEV shpreh mirënjohje për pjesëmarrësit dhe për mbështetjen e OSFA.


Metoda dhe kampioni

Pyetësori përmban 14 pyetje në total nga të cilat 4 janë pyetje demografike. Pyetësori është i thjeshtë dhe u administrua online përmes platformës SurveyMonkey dhe u dërgua me email tek databaza e studentëve pjesëmarrës në projektin e debatit universitar për integrimin. Në total u dërguan 98 email dhe pas 5 ditësh që ishte afati për plotësimin e pyetësorit, 73 studentë e plotësuan atë në javën e fundit të marsit.

Analiza që paraqitet më poshtë është thjesht përshkruese e rezultateve. Ky raport nuk ka asnjë pretendim për përgjithësimin e gjetjeve. Këto gjetje janë të kontekstualizuara vetëm për projektin dhe pjesëmarrësit e tij dhe në asnjë mënyrë nuk duhen lexuar si tregues për të gjithë studentët në Shqipëri.

60% e respondentëve janë studentë të nivelit bachelor.

Figure 1: Niveli i studimit i respondentëve




Projekti ka 13 institucione pjesëmarrëse, por respondentë janë vetëm nga 12, pasi në Fakultetin e Drejtësisë / Universiteti i Tiranës pyetësori nuk u shpërnda. Studentët pjesëmarrës këtu janë zgjedhur më vonë për arsye objektive të koordinimit.

Table 1: Shpërndarja e respondentëve sipas institucionit arsimor

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës (FHF/UT)	12%
Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FE/UT)	11%
Instituti i Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës (ISE/UT)	11%
Kolegji Universitar Luarasi (Luarasi)	11%
Fakulteti i Biznesit, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FE/UAMD)	10%
Universiteti European i Tiranës (UET)	10%
Universiteti Neë York i Tiranës (UNYT)	10%
Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FSHJP/UAMD)	8%
Universiteti i Epokës (Epoka)	7%
Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës (FSHS/UT)	4%
Kolegji Universitar Marlin Barleti (MB)	4%
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)	3%
Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (FD/UT)	0%

Pjesa më e madhe e studentëve që i janë përgjigjur pyetësorit janë vajza dhe gra (66%).

Figure 2: Gjinia e respondentëve



Projekti zbatohet në Tiranë dhe Durrës, pra përfshin vetëm universitetet e vendosura në këto dy qytete në këtë fazë pilot. Megjithatë, studentët janë pyetur në cilin qytet ata banojnë duke konsideruar që në kushtet e pandemisë ku mësimi bëhet online dhe universitetet janë mbyllur, studentët qëndrojnë në vendbanimet e tyre. 42% e respondentëve jetojnë në Tiranë dhe 14% në Durrës.


Table 2: Qyteti i banimit

Tiranë	42%
Durrës	14%
Korçë	4%
Berat	3%
Has	3%
Krujë	3%
Lezhë	3%
Vlorë	3%
Vorë	3%
Elbasan	1%
Fier	1%
Gjirokastrë	1%
Kamëz	1%
Memaliaj	1%
Mirditë	1%
Përmet	1%
Roskovec	1%
Tepelenë	1%

Prezantimi i gjetjeve


93% e studentëve raportojnë që janë në vetë-izolim në shtëpi sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe vetëm 1% janë në punës sipas rregullave dhe kufizimeve të vendosura.

Figure 3: Statusi aktual gjatë pandemisë




Shumica e studentëve raportojnë se nuk janë të punësuar apo vetëpunësuar (68%) dhe 12% raportojnë që janë duke punuar në distancë nga shtëpia.

Figure 4: Puna dhe mësimi gjatë pandemisë




Sa i takon frekuentimit të mësimin online, 66% e studentëve të pyetur raportojnë që janë duke ndjekur mësimin online dhe 23% raportojnë të kundërtën.

Figure 5: Mësimi online




Sa i takon infrastrukturës, të gjithë studentët e pyetur konfirmojnë që kanë pajisje në gjendje të mirë pune për të realizuar mësim apo aktivitete të tjera online si më poshtë. Shumica (56%) kanë laptop ose PC personal në shtëpi dhe pjesa dërrmuese (75%) kanë telefon celular personal me kamera.

Figure 6: Infrastruktura në dispozicion



Sa i takon lidhjes me Internet, 73% e studentëve raportojnë që kanë lidhje wireless me Internet në shtëpi. Ndërkohë 22% përdorin lidhjen nga telefoni (3G / 4G) dhe 12% nuk kanë lidhje të vazhdueshme me internet.


Figure 7: Lidhja me internet



Sa i takon platformave të përdorura për të realizuar mësim online apo video-konferenca, studentët raportojnë përgjithësisht: Whatsapp, Skype dhe Zoom si edhe platforma të tjera të ofruara nga universiteti.


Sa i takon përdorimit të platformave online, një e katërta e studentëve raportojnë se janë disi familjar dhe i përdorin me lehtësi një ose disa platforma dhe 18% janë shumë familjar, pra i përdorin me shumë lehtësi platformat. Ndërkohë 40% e studentëve nuk i kanë përdorur ndonjëherë (19%) ose i kanë përdorur shumë pak (21%).

Figure 8: Sa lehtë përdoren platformat online



Të pyetur se cilat do të ishin nevojat e tyre nëse debatet zhvillohen online, 68% e studentëve raportojnë se kanë nevojë për koordinim me anëtarët e skuadrës dhe mentorin. Ky është një tregues i mirë i kuptueshmërisë së tyre për rregullat e debatit të strukturuar dhe se pa koordinim nuk mund të realizohet me sukses. 59% raportojnë se kanë nevojë për trajnim dhe udhëzime për të përdorur platformën online që do të përdoret. Kjo nënkupton punë përgatitore nga ana e SCiDEV, skuadrës së projektit dhe mentorëve për të mbështur studentët dhe realizimi i trajnimeve që sërish do të duhet të bëheshin online.

Figure 9: Nevoja për debatet online



Shumica e studentëve raportojnë që situata e re u ka bllokuar aktivitetin normal dhe u ka shkaktuar një lloj gjendjeje apatie dhe ‘parazitizmi’ duke mos bërë asgjë me vlerë gjatë qëndrimit në shtëpi, përveç disa lëndëve mesim online. Të tjerë raportojnë që kjo periudhë i ka shërbyer për reflektim dhe për rilidhje me familjarët e tyre në shtëpi, por edhe atyre që janë më larg përmes lidhjeve online. Të tjerë studentë raportojnë që janë ngadalësuar aktivitetet e tyre normale, por kanë filluar aktivitete të tjera në kushtet e vetë-izolimit.

Grafikët e plotë mund të gjenden [këtu](#).

Përfundime

Duke u nisur nga të dhënat e pyetësorit si edhe bashkëbisedimet me pedagogët mentorë, sugjerohet që vendimi për realizimin e debateve online të shtyhet për pas datës 25 prill për të parë edhe ecurinë e situatës.

Realizimi i debateve online nuk është e thjeshtë, pasi debatet e strukturuar ndjekin një procedurë strikte dhe kërkojnë shumë koordinim mes anëtarëve të skuadrës dhe mentorit që mund të jetë e vështirë të realizohet online.

Edhe pse studentët kanë pajisje për të realizuar debatet online, një pjesë e mirë kanë mungesë të lidhjes së vazhdueshme me Internet. Debati online kërkon prezencën e më shumë se 12 personave kështu lidhja duhet të jetë shumë e mirë. Gjithashtu pjesa më e madhe raportojnë që kanë shumë nevojë për trajnim dhe mbështetje për përdorimin e platformave. Kjo shton presionin mbi SCiDEV që ka burime të kufizuara.

Në këto kushte, SCiDEV do të vazhdojë të nxisë studentët të jenë aktiv përmes fushatës online të qëndrimit aktiv, rubrikës Blog dhe përgatitjes së videove me mesazhe sensibilizuese. Kjo do i ndihmojë me reflektimin dhe me njohjen më të mirë të projektit dhe mundësive që ofron teknologjia.